



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilbjen Me Data 19-03-2025			
Nr. Propozimit Gaz. Broj	Nr. Propoz.	Vitet e Vitet	Vlera Vlerdnost
01-060	01		224



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **III** të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **27.03.2025 (e Enjte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti. Mbledhja është e hapur për publikun. Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Kuvendit Komunal,
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronën komunale përmes ankandit publik. (pika nga seanca e kaluar).
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. (pika nga seanca e kaluar).
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronën komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës afatgjat.

Viti, më 19.03.2025



Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË DYTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 27.02.2025 (e enjte) në shtëpinë e kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit, si: z.Ramadan Deliu, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ali Bajrami, z.Sokol Hyseni, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Arbnora Hajredini, znj.Marigona Avdiu, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, znj.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Zyrafete Rama, z.Durim Sylejmani, z.Reshat Azizi, z.Taulant Haxhiu, ndërsa mungoi, z.Sokol Shaqiri, z.Basri Sylejmani, znj.Liridona Bislimi, z.Veton Ramadani, znj.Anisë Zejnullahu. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike, dhe të tjerë. Pasi u konstatua se prezent janë 22 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dytë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Gjatë kësaj periudhe kohore nga seanca e fundit nuk janë kthyer aktet e ligjshmërisë ende sipas ndryshimit të ligjit. Tash aktet kanë afat deri 30 ditë të kthehen që kanë qenë më herët brenda 15 diteve. Materialin e keni marrë me kohë dhe kur e kemi pikën e raportit të kryetarit, atëhere pjesën e parë e kemi pyetje përgjigje që të diskutohen me një pikë të raportit, prandaj drejtpërdrejt shkojmë me rendin e ditës. Për këtë seancë kemi parapa këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e kuvendit komunal.
2. Informatë (raport) e punës së kryetarit të komunës për periudhën janar-dhjetor 2024.
3. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-dhjetor 2024.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet rendi i ditës. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e kuvendit komunal.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat, a jeni që të miratohet pika e parë e rendit të ditës. Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Informatë (raport) e punës së kryetarit të komunës për periudhën janar-dhjetor 2024

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pasi që kemi kuvendin e parë të mbajtur pas një procesi zgjedhor që kaluam dhe ne si akter të politikës, por dhe si qytetar të Komunës së Vitisë, të cilët do t'i kisha falenderu të gjithëve për një proces korrekt, demokratik. Këtij procesi besoj që ju keni parapri dhe vetë ju, në veçanti kandidatët të cilët kanë qenë për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, që i përgëzoj për punën e tyre. Megjithatë si individ kisha dëshirë që të gjithë të kalojnë, por megjithatë procesi është proces dhe duhet ta pranojmë ashtu si ka përfunduar. Një falenderim i takon dhe grupeve të këshilltarëve komunal për informatën, sepse ju e dini që ka pas me qenë në janar, keni pas atë mirëkuptimin nga ana juaj, që për shkak të procesit zgjedhor me një mirëkuptim të plotë që kemi mëndur, që muaji shkurt do të jetë më i përshtatshëm për informatën, edhe pse edhe në janar ka qenë e gatshme. Kryetarin e kemi në mungesë me arsye, për shkak një rast vdekje, dhe unë sot para jush do të paraqes këtë informatë. Ne kemi të përgatitur edhe një program dokumentar për punët të cilët janë kry, por në koordinim me kryesuesin, mos me ju lodh, për shkak materialin të cilin e keni, kemi vendos mos me shfaq për punët të cilët janë kry dhe ato të cilat nuk kanë mund të kryhen. Unë kam qenë në mesin e tyre që kam punuar në lidhje me raportin së bashku me ekipen, dhe konstatoj që raporti prej 58 faqeve në aspekt teknik dhe përmbajtësor i plotëson të gjitha konditat që të jetë para jush, deri sa ka kalu përmes Zyrës Ligjore dhe lektorit. Ndoshta mund me pas ndonjë lëshim, por filtrat i ka kalu të gjitha. Informata përbehet nga 3 kapituj. Në kapitullin e parë të cilën e ka hyrjen, në të dytën zyret e kryetarit, duke fillu prej Njesisë së Auditimit, Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për të drejtat e njeriut dhe komitetin, Zyra për Barazi Gjinore, Zyra Prokurimit, avokati publik komunal, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun dhe Zyra për Integritet Europian. Përveç këtyre zyreve të cilët i keni të gjitha punët të cilat unë nuk do të ju lodhi. Pasi që keni materialin para jush, i keni parë dhe punët të cilët janë kryer brenda periudhës kohore 2 janar 2024 deri me 31 dhjetor 2024, ekzekutiva përbëhet edhe nga 10 drejtori, tu fillu prej Drejtorisë së Administratës e deri në përfundim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, të cilat i keni të shkoqitura në raport të gjitha punët të cilat janë kry në kuadër të vitit 2024. Krejt ky material është përfshi me një volum prej 58 faqeve. Unë që të mos ju marrë kohë, pasi që keni marrë materialin me kohë, ju lë kohën juve që të bëni pyetje rreth pakjartësive. Një çështje e di që, në raport mund të ketë vërejtje, sugjerime, por ndryshime nuk mund me pas, për shkak se raporti paraqet një gjendje faktike për një periudhë të caktuar kohore. Me knaqësi do të i kisha pritë të gjitha pyetjet dhe sugjerimet që mund të dalin, për shkak që ju menjëherë pas kësaj do ti keni edhe pasqyrat financiare të cilat i shihni edhe ekzekutimin e buxhetit, dhe ajo që kisha me thanë për vitin 2025, përveç problemeve rutinë që mund me ndodhë ekzekutives, konkretisht kryetarit të komunës në kabinetin vetë gjatë ushtrimit të funksionit, një pengesë që unë konsideroj që ka qenë një prej më të mëdhajave që na ka përcjellë, sidomos në përfundim të vitit ka qenë edhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, konkretisht i kontratës kolektive. Ne jemi ballafaqu me këtë problematikë edhe pse në përfundim të vitit, në muajin 11 dhe 12 i kanë rimbursu në veçanti çështjen e kodit të pagave, se përndryshe ne ndoshta do të ishim ballafaqu në mungesë të pagave, për shkak të ekzekutimit të atyre mjeteve. Megjithatë sërish në këtë vit ka fillu starti, megjithatë ne po kërkojmë ju kemi drejtu dhe me shkresë edhe ministrit të financave, që ndoshta ky problem meriton një trafikim global, jo parcial, vetëm për Komunën e Vitisë, por gjithsecili e shtron në aspekt individual të vetin, dhe unë mendoj se do ta gjejë një zgjidhje dhe të lirohemi prej kësaj barre të cilin e bartim me vite të tëra.

z.Ali Bajrami: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket informatës rreth punës 1-vjeçare të kryetarit, është një obligim ligjor që është i ndamë në 2 faza, 6-mujori dhe përfundimtari janar-dhjetor 2024. Nënkryetari e elaburoj në pika të shkurtra. Materialin e kemi marrë, duke fillu prej zyrave të kryetarit, drejtorit, të gjitha punët i kanë kry me përgjegjësi të plotë dhe ndershmëri. Është një punë voluminoze që është bërë gjatë këtij afati kohorë njëvjeçarë. Në krejt këtë duke ju falenderuar edhe neve si këshilltar komunal që kemi mbështet, i kemi votu të gjitha ato që kanë qenë në dobi të komunës dhe qytetarëve të Komunës së Vitisë. Për krejt këtë unë i kisha përgëzu edhe kryetarin, nënkryetarin, kryesuesin, drejtorët, këshilltarët komunal për një punë të suksesshme njëvjeçare dhe të përgjegjshme.

z.Jakup Demiri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket raportit të kryetarit, unë do të ndërlihem pak më vonë, ndërsa kohën e shefit të grupit ja kisha kalu asamblistit Nexhatit.

z.Nexhat Halili: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Rreth raportit të kryetarit, po e nisim prej Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Njësia e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 ka pas planifiku 2 auditime dhe ka realizu 2 auditime, mirëpo vërejtja ime është kështu. Këto 2 auditime janë parapa në 6-mujorin e parë, tash në 6-mujorin e dytë a ka ndonjë auditim që është kry brenda kësaj periudhe, për shkak që shihet te Njësia e Auditimit krejt janë të bartura prej 6-mujorit të parë dhe në 6-mujorin e dytë. D.m.th në vitin 2024 dhe kur të përgatitet një raport i auditimit për menaxhimin e kontratave duhet pak një elaborim. Cilat kontrata janë elaboru, ku kanë pas ndonjë vërejtje specifike, ndonjë udhëzim se si duhet të veprohet, mirëpo këtu nuk po shihet që kanë vepru në atë mënyrë. Rasti tjetër dhe Zyra për Barazi Gjinore, gati se raporti është i bartur prej 6-mujori të parë në 6-mujorin e dytë. Zyra e Prokurimit shihet që i ka kry diku 60 aktivitete ku janë përfshi landë të prokurimit, shërbime të prokurimit me një vlerë të përgjithshme prej 9 milion e 512 mijë 801.21 euro, por nuk janë të elaboruara. P.sh.: se cilat procedura në çfarë vlere shërbimet, sa punët, sa janë furnizimet dhe konkurse të projektimit, plus i kemi 3 aktivitetet të procedurës së negociuar. Unë nuk po mund me i vërejt se cilat aktivitete janë, a janë punë shtesë a janë punë të negociuara. Te pika, avokati publik i komunës, i njëjti 6-mujor është bartur në vitin fiskal. Po të mirret të shihet copy-paste prej 6-mujorit të parë, i njëjtë është. Një pyetje e kam. Avokati publik i komunës ka të drejtë të nënshkruaj 4 kontrata të dhurimit të paluajtshërisë, në të cilat komuna paraqitet si dhuratëmarrës. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun nuk ka raport hiq në këtë vit, sikurse Zyra Ligjore. Tash po të shihet në faqe 10, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, kur të hynë në brendësi shihet që është Zyra e Projekteve. E njëjtë është edhe te Zyra e Integriteteve Europiane, dhe kjo është bartur prej 6-mujorit. Tash po ndërlihem tek Drejtoria e Administratës. Te kjo drejtori shpenzimet e mbajtjes së automjeteve dhe gjenerator për të gjitha njësitë shpenzuse janë 47 mijë e 741 euro. Po të bëhet krahasimi me pasqyrat financiare, atëhere del një mos përputhje. Te mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, te pasqyrat financiare ki 36 mijë e 163 euro, ndërsa te raporti i kryetarit i ki 47 mijë e 741 euro. Kjo është një diferencë 11 mijë e 578 euro. Tek Drejtoria e Administrates, Sektori i Administrimit, njëjtë. Kur të llogariten derivatet e naftës, dalin vlera krejt të ndryshme. Kemi rastin tek e njëjta drejtori kemi shpenzime të sigurimit të automjeteve. Te raporti i kryetarit i ke 9389.91 euro, ndërsa te pasqyrat financiare 8204.46 euro. 1185.45 euro i ki diferencën. Drejtoria e Inspektionit, udhëheqësi i Sektorit të Inspektionit, në raportin të cilën e ka paraqit ky, ka paraqitë vetëm përshkrimin e detyrave, por jo edhe aktivitetet, edhe pse ky si udhëheqës i sektorit nuk u dashtë të i përfshij të gjitha. Tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, kur të elaborohet raporti shihet se ky është copy-paste prej 6-mujorit të parë dhe në 6-mujorin e dytë në faqen 20, kjo drejtori ka paraqitë se ka pas për vitin 2024 buxhetin në shumën prej 1 milion 384 564.18 euro. Periudha janar-qershor, kështu shkruhet në raport, është shpenzuar 907 mijë e 701.66 euro, që d.m.th 65%. Kur krahasohet me raportin vjetor të paraqitur për vitin 2024, në pasqyrat financiare buxheti i aprovuar për vitin 2024 është 1 milion e 575 768.58, kurse shpenzimet janë 1 milion e 561 mijë e 191 euro e 94 cent. Diferenca e buxhetit të aprovuar është diku 191 mijë 204 euro në mesë raportit të kryetarit dhe raportit të drejtorisë. Të njëjtën e ke dhe te diferenca e shpenzimeve. Te ndriçimi publik, këtu potencohet se është lidhur një kontratë të ndriçimi publik, mirëpo shumë fshatra nëpër lagje të ndryshme nuk kanë ndriçim publik të instaluar dhe ato jo vetëm nëpër lagje, por edhe nëpër rrugë kryesore. Ke rastin në Sodovinën e Muhaxhirëve, Trestenik etj. Ujësjellësi dhe kanalizimi është e vërtet se përgjegjës për sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit është “Hidromorava”. Kohëve të fundit ka marrë në menaxhim edhe ujësjellësin e 5 fshatrave: Trestenik, 2 Sllatinat dhe 2 Sodovinat, por ende banorët e këtyre fshatrave nuk kanë ujë të pijes. Po detyrohen të bartin ose të hapin puse me kosto të larta. Këta banorë, përveç shpenzimeve me ujë të pijes ata shpenzojnë edhe për çdo muj për ujësjllës që nuk e përdorin për pije. Sa i përket kanalizimit, në seancën e kaluar kam paraqitur rastin e bllokimit në fshatin Trestenik, Lagjja e Muhaxhirëve. Kanalizimi është bllokuar dhe mbeturinat e këtij kanalizimi kanë dalë mbi sipërfaqe të tokës, të cilat kundërmojnë erë të pakëndshme dhe jeta e tyre është bërë e papërballueshme. Banorët kanë paraqitur këtë shqetësim në strukturat përkatëse të “Hidromoravës”, por dhe te Drejtoria e Shërbimeve Publike. Mirëpo deri më tani nuk ka pasur sukses. Unë vetë këtë rast e kam paraqitur para punonjësve të “Hidromoravës” të cilët më premtuan që do të marrin hapa në këtë

drejtim, mirëpo deri më tani asnjë hapë nuk është marrë. Mbetem me shpresë se do të mirret ndonjë hapë në këtë drejtim. Banorët e këtyre lagjeve të jetojnë ashtu si e meritojnë. Tek Drejtoria për Kadastër, Pronë, te pika e të hyrave financiare, planifikim i të hyrave vjetore për vitin 2024, duke përfshi sektorët, ka qenë vlera e planifikuar 84 mijë e 181 euro, ndaras të hyart janar dhjetor të realizuara 86106.05 euro. Sipas raportit të kryetarit, vlera e planifikimit është në rregull dhe te pasqyrat financiare, mirëpo vlera e realizmit nuk përputhet me pasqyrat financiare. Vlera e realizmit sipas pasqyrave financiare është 93 mijë e 578 euro, diku një diferencë 7472.95 euro. Tani për momentin nuk dihet se ku është gabimi, a është te pasqyrat financiare apo tek raporti i kryetarit. Drejtoria e Financave, Ekonomi dhe Zhvillim, faqe 58, inkasimi nga taksa, automjete janë në velrë 106540.50 euro, ndërsa në bazë të pasqyrave financiare, në faqe 19 vlera e tyre është 127766 euro. Diferenca është 21 mijë e 225.50 euro. Edhe këtu nuk dihet se a është gabimi te pasqyrat financiare apo te raporti i kryetarit.

znj.Zyrafete Rama: Përshendejte për të gjithë të pranishmit! Me shumë vëmendje e kam përcjellë informatën e kryetarit dhe punën e zhvilluar në vitin 2024. Çdo punë e mirë që behet për qytetarët e Komunës së Vitisë, nga kushdo qoftë, i duartrokasim dhe e falenderojmë, por unë sot dua të potencoj një fakt që na ka përcjellë me vite, e që ka të bëjë me cilësinë e dobët të projekteve. I nderuar nënkryetar, ju lutem shumë që përfundimisht të ndalet kjo praktikë me këto projekte jo cilësore, që ende pa u përuar po kërkohet rinovim. Po kërkoni nga ju që të kërkonte llogaridhënie dhe dhe kontroll në shpenzimin e parasë publike për qytetarët e Komunës së Vitisë.

z.Musli Neziri: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Kemi marrë materialin dhe kemi përcjell punën që është bërë. Raportin e kryetarit të komunës, megjithatë pajtoj me parafolësin, një pjesë janë shumë të bartur nga raporti i 6-mujorit të parë. D.m.th kanë shku shumë me copy-paste, mirëpo isha ndal tek Drejtoria për Inspeksion pak. Aty i kemi 3 pozita të lira të punës që mungojnë njerëzit aty. P.sh.: gjeodeti zyrtar për matje, rrjet, gjeometër mungesë, inspektori i shërbimeve publike mungesë, inspektori i uzurpimit të pronës mungesë, d.m.th nuk e di pse me pas mungesë kur mund të ketë kuadër që mund të angazhohet. Këtu është cekë që, shpresoj të kryhet gjatë vitit 2025, mirëpo të njëjtën pyetje e kam në pjesë tjera për Drejtorinë e Shërbimeve publike ndoshta pikërisht përshkak të mungesës së inspektoreve do të nderlidhem me pyetje tjetër.

z.Illir Zuka: Përshendetje për të gjithë të pranishmit, fillimisht më lejoni që në emër tim personal të ja uroj muajin e shenjt të ramazanit se e dimë që nga e shtunja do të jemi në muajin ramazan. Nënkryetar, unë e kam një pyetje, sa është tu ndiku kontrata kolektive për mos përfundimin e projekteve, kur e dimë që shumë projekte edhe që po janë në proces të kryesjes. E dimë që po janë shumë projekte që kanë pas mjete të alokume, edhe ju kanë marrë. A është tu ju qitë problem të madh dhe a do të vazhdon edhe këtë vit me këtë problem.

z.Taulan Haxhiu: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Veçanarisht desha t'i falenderoj qytetarët e Komunës së Vitisë. Unë isha pjesë e garës në zgjedhjet parlamentare. I falenderoj gjithësecilin për kontributin që kanë dhënë dhe më kanë përkrah mua dhe subjektin tonë politik. Pritshmëritë e mia kanë qenë më të mëdha, por rezultati është ky. Uroj partinë fituese në Viti, që ka fitu gati 50% të zgjedhje. Kjo është demokraci. Pritshmëritë kanë qenë më të mëdha për shkak se unë kam qenë pjesë e garave komunale. Zakonisht në gara komunale njëri mbështetet nga potenciali vet komunal dhe aty kam pas suksese. Këtu jam mbështet dhe nga unë dhe nga aktivistat, dhe rezultati është ky. Nuk besoj se do të dëshpohem dhe do të jem pjesë aktive e politikës vitiase. Megjithatë çdo sfidë ka humbje dhe fitore dhe si këshilltar komunal zgjedhjet e para i kam humb, mandej në të dytat dhe të tretat kam dalë. Një ndër njerëzit më të votum në Komunën e Vitisë. Ju falenderoj të gjithëve. I nderuari nënkryetar, unë më së pakti që 6 - 7 muaj kam fol dhe kam diskutu për shumë çështje, por çështjen kryesore që kam diskutu është ajo që nuk mund qytetari të funksionoj. Pa të d.m.th pa ujë, ju e dini qyteti i Vitisë nuk ka ujë në qoftë se, nuk kemi ujë, nuk kemi çka bisedojmë për projekte. Ne i kemi bërë një shesh këtë shesh që kemi këtë grandin e performancës. Kemi blloku Vitinë pa arsye. Sheshi nuk është funksional. E kemi bërë këtë rrugën me kalldrëm dhe kjo më mirë mos të ishte është jashtëzakonisht projekt i dështum për mua personalisht. Trotualet që kemi shtu gjatë këtij mandati prej "Linidit" deri te Mediterani i cili është prishur tërësisht. Kemi një trotuar te rruga Pozheranit deri te "Shelli" që 2 persona nuk mund t'i nxen në atë trotuar. Kemi premtu një rrjet të ujësjellësit Terstenik, Sodovinë e Jerlive, Sodovinë e Qerkezëve 15 mijë euro. Tani 55 mijë euro nuk i kemi realizu qytetarët e Komunës së Vitisë. Nuk janë të knaqur me asnjë punë që kemi bërë deri më sot. Çdo projekt që po bëhet nuk po qëndorjnë më shumë se 7 - 8 muj. D.m.th çdo punë që po bëhet sot është bërë më një punë e

dobët, jo kualitative. Unë e di që nuk është kompetencë e juaja KEDS-i, po ju e dini që Vitia ka një problematikë të madhe me rrymë, sidomos në krejt qytetin e Vitisë, sidomos në rrugën "Hasan Prishtina" në katin e parë. Kemi rrymë në të dytin jo. Jeni persona që mundeni me ndiku më shumë te KEDS-i sesa qytetarët. D.m.th kjo është një katastrof që qytetarët e Vitisë janë përballu me KEDS-in që 6 -7 muaj. Ka pas edhe protesta në lagje të ndryshme të Komunës së Vitisë. Ta kam bërë edhe një kërkesë, 20 here të kam thanë për rrugën që është shumë qarkulluse rruga "Hasan Prishtina". Për një polic të shtrirë nuk keni marrë asnjë vendim, as nuk keni qenë as me pa. Rrezikohen dhe fëmijët, është një rrezik i jashtëzakonshëm, d.m.th qytetari na ka votu neve me i diskutu problemet e tyre në kuvend. Ne vetëm kemi bërë fjalë këtu dhe kemi diskutu, por asnjë gjë që kemi diskutu ne nuk është kry prej kësaj qeverisje komunale. Si qeverisje komunale ne nuk kemi pas rezultat pozitiv dhe për këtë na e tregu vendin qytetari. Partia opozitare ka marrë 49% në Viti edhe kjo është një punë jo e mirë që kemi bërë ne edhe si koalicion PDK-LDK në Komunën e Vitisë.

znj.Majlinda Shabani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Së pari dua të falenderoj dhe të shpreh mirënjohje të thellë ndaj çdo qytetari të Komunës së Vitisë për besimin e dhënë për mbështetje në zgjedhjen e 9 shkurtit, ku Lëvizjen Vetëvendosje. E nxorën si parti fituese, fitore kjo e cila po dyshim që do të rritet me vota të mërgatës. Edhe në këto zgjedhje konsideroj që mesazhi i gjith qytetarëve të Komunës së Vitisë ishte i qart, përkundër gjithë presionit të vazhdueshëm nga pushteti lokal, përdorimit të të gjithë mekanizmave, vota e tyre ishte demokratike dhe votë e cila nuk mund të blehet dhe ndryshohet. Konsideroj që ka qenë votë e cila ja ka treguar vendin LDK-së dhe Sokol Halitit, i cili ka qenë kandidat për deputet, sepse kështu është kur mashtron, kur besimin e dhënë për qeverisje e keqpërdor, dhe kështu është kur nuk bënë punë dhe zhvillim për vendin. Me lejoni të potencoj që Sokol Haliti si kandidat për deputet ka humbur edhe në fshatin e tij në Beguncë, e kjo është dhe një mesazh akoma më i qartë, sepse zgjedhjet lokale konsideroj që janë shumë afër. Tani po i kthehem raportit të punës që realisht vetëm raport të punës nuk do të mund ta quaja. Nëse do më pyesni mua, unë do të kisha emërtu raport të mos punës së kryetarit, se vetëm punë këtu nuk ka tash, për dallim prej raporteve të tejtra për të cilët i kemi diskutu në secilin vit në 6-mujor dhe pas gjitha kritikave të vazhdueshme që kemi bërë në këtë raport që ju e keni sjellë në kuvend komunal. Ajo çka na intereson më së shumti neve si asamblist, por edhe si qytetarë është raportimi i investimeve kapitale që janë bërë në periudhën vjetore dhe për raportimin që ne jemi tu e bë. Lista e investimeve kapitale për vitin 2024 mungon dhe nuk e keni sjellë në këtë raportim, përpos kritikave dhe ato çka ju tha kolegu asamblist. Ajo çka keni prurë ju në raportim vjetor në kuvend komunal është punë administrative obligative që i takojnë secilës drejtori me bërë me raportu për punët që drejtorja i ka, por këtu nuk ka zhvillim, nuk ka as punë. Tash unë po muj me kuptu që ndoshta është një far lloj ikje dhe frike prej përblalljes me realitetin dhe prej dështimeve të vazhdueshme që i ka kryetari, i cili tashmë veç dihet që është në ikje të qeverisjes së tij për të gjitha premtimet e dhëna, jo vetëm në këtë mandat, por po themë dhe për mandate të tjera të kaluara e që nuk i ka realizu, por edhe ka dështu. Kryetari Haliti ka dështu në secilin investim kapital që e ka bërë në Komunën e Vitisë. Kritikat tona të vazhdueshme kanë qenë për cilësinë e punimeve që janë bërë në Komunën e Vitisë. Unë e kam edhe këtu fotografi ku shihet cilësia e punimeve që bëhet në Komunë të Vitisë, e po shihet se si keqpërdoren taksat e qytetarëve. Pyetja ime është pse nuk është bërë raportimi i investimeve kapitale në Komunën e Vitisë, edhe pse nuk jepni asnjë informacion se si duhet. Sa i përket raportit të punës, se unë po e kuptoj që ju mundeni me tentu me naj fy inteligjencën, po është një punë e cila shihet me sy, për ata që dojnë me pa. Unë po konsideroj që qytetarët e Komunës së Vitisë më shumë se kurr janë tu e pa këtë qeverisje. E për fund unë po konsideroj që ky ka me qenë raporti i fundit dhe jam i bindur që ka me qenë i fundit që kemi me diskutu nën udhëheqjen e këtij kryetari, i cili për një dekadë qeverisje nuk ka mundur as plotësimin e nevojave elementare të qytetarëve të Komunës së Vitisë.

z.Jakup Demiri: Me raportin e kryetarit e kemi kry me pjesën e Nexhatit, por kam disa prej pyetjeve dhe sugjerimeve të mia. Nisem tek sheshi i qytetit, që në muajin qershor patëm thanë që po besojmë që kryhet në javën e parë të muajit korrik. Tash jemi në muajin shkurt të vitit tjetër dhe sheshi nuk është kry. Po bëhet 1 vit që qytetarët maltreohen edhe nuk ka përgjegjësi këtu bllokim total. Rruga me kubza. E ceku edhe Taulanti, këtu kemi diskutu edhe me nënkryetarin. Aq shumë i ka thurë lavde nënkryetari, po të kishte qenë përnjëmend rrugë me kubza siç duhet, edhe ne nuk jemi kundër aty, por veç sa shqetësimin e kemi prej qytetarëve aty që banojnë

prej zhurmës që krijohet, nuk munden as me fjetë. Dhe tjetra, më shihet tash në çfarë gjendje është investimi. Mundemi me thanë është kotë fare. Edhe këtu po mendoj që duhet me marrë përgjegjësi, trotuaret në territorin e Komunës së Vitisë. Ato po flasim që po i afrohen 4 vitshit pa u kry. Disa prej tyre i kam vizitu dhe tash trotuari në Tërstenik, Pozheran, Smirë. Për këtë të Smirës kam fol dhe po flas tash që është pa u kry, dhe e paraqet kogjo problem edhe për fëmijët. Ka pas edhe lëndime që kam marrë prej banorëve aty që janë lëndu fëmija, se ke diku 70 - 80 cm gropa që as nuk kanë paralajmërime. Mos të flasim që aty e qet dhe natën, dhe ndriçimi publik her funksionon herë jo. Dhe ndriçimi publik, Bekimi është i Smirës, qe 3 vite funksionon ditën, por natën jo. Gjithsesi i rregullt, ndërsa ditën funksionon është viti i 3-të. Edhe sot ka erdhëm sot në mëngjes kenë të ndezura. Për ujin e pijshëm, në vazhdimësi qe nja 10 vite flasim për ujë të pijshëm, por ujë të pijshëm nuk kemi, ujësjellës nuk kemi. Në zgjedhjet e kaluara që tash po him ne vitin e katër, jan promovu dikune 20 fshatra që kanë sistem të ujësjellsave në fshatra, po tash po diskutohet për me ba ujin e pijshëm edhe me marrëveshjen e filon. Por besoj që Vitia është një përfituese po ujë të pijshëm nuk ka. Çka po mbetet ato të fushatës, fotografitë e filmat që i kemi pa tu e promovu ujin e pijshëm, borgjet ndaj operatorëve ekonomik. E pash te informata e kryetarit janë 2.5 milion euro. Këtu ka edhe nga kontrata kolektive, po borgjet kryesore jan tubu per shkak edhe të mos planifikimit të mirë. Na e dimë që korniza afatmesme buxhetore, e vetmja Komuna e Vitisë nuk ka dorëzu listën e investimeve kapitale hiq, e tash kurë nuk e parasheh e kur nuk e din, kur e kemi miratu buxhetin, unë e kam hulumtu, dhe sipas hulumtimeve që i kemi bë, dikun 27 projekte në komunën tonë janë me nga pesë vite që zgjasin pa u kry. Tek cilësia e projekteve, që fatkeqësisht këtu është puna edhe tek projektimi, i kemi nja tri kontrata brenda pesë viteve që e kapin shumën rreth 800 mijë euro, që jepen tendera me i bë projekte Komunës së Vitisë dhe projekte nuk ka, po për këtë me detaje do të flasim në mbledhjen e radhës. Si pikë të rendit të ditës kemi mi pas edhe projektet në komunën tonë, ndërsa një prej rrugëve që është e asfaltume, në rrugën Smirë-Kabash është kjo gjendje. Shif fotot. Dje i kam bë këto foto. Mirë është me dal në teren me pa si e ka marr uji krejt, sepse rruga është shtru po nuk ka kanale anash. Vetëm kanë qit asfalt. Tash dimri, uji e ka bajt krejt dhe hin dora ner asfalt. Po nuk është vetëm kjo. Unë këtë rrugë e kam fotografu veres, vetëm një muaj pasi u shtru ajo rrugë, dhe kjo është gjendja. Shif në foto si është, çfarë asfalti. Kjo është cilësia e rrugëve tona. Tash a është punë ingjinjeri apo tenderi, apo asfalti, po kryesorja ne shtrojmë rrugë. Është e vërtet, po po shifet qëndrueshmëria, sepse këto janë para të taksapaguesve, edhe po, është papërgjegjësi. Edhe rruga që është shtru me zhavorr atje përmbi fshat tonin, vetëm ka fillu me u bë e pakalueshme pikërisht për shkak se nuk ka kanale rrugës, nuk ka ka hec uji. Viti i dytë që qarkollon uji përmes rrugës dhe ka fillu me u prishë, e tash për automjete limozia është e pakalueshme. Rruga mundeni me shku me pa, e krejt për këto nuk ka përgjegjësi nga ingjinierët, mbikëqyrësit, projektuesit, projektet të cilat nuk funksionojnë duhet edhe me marr përgjegjësinë se nuk është gjithçka mirë. Ne e dimë se si qeveriset Vitia që një kohë të gjatë. Këto zgjedhje kanë shku mirë, jemi mundu me qenë të kujdesshëm, ama pa e cek tash nuk muj, se janë shfrytëzu edhe konkurset për vota. U shkel edhe ligji, po krejt çka po du me thanë, po du me thanë që ne kot po flasim e po ngrisim shqetësime, se kush nuk po na ndëgjon si perinati. Trotuari në Smirë ka qenë dashur me u kry deri tash, se hecin njerëzit aty pari. Rrugët, cilësia e dobët. Me intervenu! Nuk jam i kënaqur me disa punë.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Meqenëse u fol shumë rreth informatës së kryetarit un nuk du me u ndal në shume detaje po para pak tek avokati publik i komunës të cilin e përmendi edhe Nexhati po nëse është avokati këtu e kam një pyetje për ta a ka ndonjë lende kontestimore a po qfardo lende qoft ajo që lidhet me komunene dhe avokati që përfaqëson se e ka fituar kontestin ne gjykat, pastaj thuhet se ne marrjen e vendimeve konsultohet me kryetarin, zyrën e kryetarit dhe drejtorit normalisht që duhet të konsultohet ajo është e drejt dhe patjetër që duhet të konsultohet mirë po kur të jen në pyetje interesi i qytetarit edhe nëse konsultohet me zyrën e kryetarit a po ndonjë drejtori ai duhet ta përfaqësoj të drejtën mendimi e vet si person ligjor, dhe un këtu nuk po shof që ka trajtuar ndonjë lënde që le me kuptu se verte që ato lënde që ai i ka perfaqesu jan të fituara a po a po është vetëm dëgjim i kryetarit edhe recitim në gjykat se qka ja përcjellin zyret e tij, këtu kam edhe një vërejtje tjetër thot 12 raste të natyrës kontestimore të demit cilat jan ato zakonish thot me shpenzime faktike pa procedur të rregullt të shpronësimi një të till e kemi diskutu në seancat e me parshme e cila është tash nuk e di se e ka kalu shifrën mbi 400 mij ku është llogarit edhe përqindja nuk e di saktësisht e pastaj këtu i kemi edhe 12

të tjera kush do ti paguan këto shpronësime edhe pse këto shpronësime janë pa pëlqimin e palëve por janë vetëm në menyre at hok aty per aty ose ta kry punën ne e të tjetere pastaj le të ankohen se taksat e qytetarve mundemi ti shfrytezojm qysh te kemi qef ne, tjetra kur thonj të verteten Taulanit e Jakupi faktet flasin vet te rruga me kubëza rreth lumit morava un personalish kete nuk do ta quaj si një projek i dështuar por do ta quaj si një implementim i projektit të dështuar dhe nëse komuna nuk merr mas që ai projekt të vihet në vend dhe të implementohet ashtu si që duhet un personalish do ta quaj edhe projekti si të dështuar pasi që kemi tash edhe pyetje te kryetari ne sa fshatra të komunës së Vitise ka uj të pijshëm dhe e dyta munde të jete ndoshta edhe pak qesharake mir po tash mendimi është i lir e me pyet kryetarin a ka ndonjë porn private që nuk ja ka ofru asfaltin prone tij personale që nuk ja ka afu asfaltin.

z.Basri Aliu, drejtor: Përshëndetje të ndaruar të pranishëm! Nexhati tha se, raporti është kopi past. 6-mujori është brenda vitit 2024, dhe i kqyrë statistikat a janë të njëjta. Gabimi teknik ka mujtë me ndodh për buxhetin që the janar-qershor, ndërsa statistikat tjera mundesh me hi me i kqyrë a janë të njëjta. Kështu që, nuk qëndron ajo që po thua kopi paste, sepse nuk është. Fjalitë janë edhe për 6-mujorshin e parë edhe për të dytin. Rreth kanalizimit në Trestenik. Nexhat, e di shqetësimin, por kompania “Hidromorava” është kompani rajonale e cila ka marrë përgjegjësinë. Sigurisht atje keni pas mundësi me ndiku më shumë, sepse udhëhiqet prej partisë së juaj. Rreth ndriçimit do të ju sqaroj Xhelali më shumë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Faleminderit! Rreth pyetjeve të cilat janë shtru, edhe pse me disa jo që nuk pajtohem unë, nuk pajtohen rregullat e demokracisë. Se herë pas here po dalin jashtë konturave të cilët po e personifikojnë personin në ikje, ardhje, shkurje. Çdo punë e ka kohën e vetë, duhet të pritët koha. Nuk kemi nevojë për lëndime të njëri tjetrit. Nevojë për me vrapu për me mujtë gjithsecili ka nevojë, vrapon në subjektin e vetë. Duhet ta mësojmë këtë kulturë, se do jeni të ri këtu dhe disa nuk kanë as në luftë. Duhet ta dimë, kemi nejt këtu edhe nuk ik edhe kur humb, por edhe kur fiton është këtu. Çështja tjetër si emruet i përbashkët. Unë mundem me u pajtu me Zyrafeten, Jakupin, Taulantin që ngritjen e cilësisë që po e kërkoni, urdhëroni dhe ju në kumturat e juaja ndihmoni edhe ne po bajmë përpjekje dhe ne nuk jemi të pajtimit me disa të cilat po ndodhin. Nuk ka projekt për të cilin nuk e kam thirrë inxhinierin me pyet, jo vetëm të komunës, por edhe atë projektuesin dhe implementuesin, megjithatë ato kanë ndodh, por unë besoj që çdo ditë vetëdija jonë dhe institucionale, implementuse, projektuse duhet të ngrihet në këtë drjetim që të prodhojmë projekte të qëndrueshme. Për çështjen që tha këshilltari të bartura, për këtë Basriu e përfshini. Te shumë zyre përsëri bartet kjo. D.m.th prej 6-mujori bartet 1-vjetori. Në rast se ndryshojnë shifrat është në rregull, në rast se shifrat i ke të njëjta, atëhere mundet me pas ja mos punë të asaj zyre për 6 muaj apo atëherë mundem me u pajtu që ka kopi paste. Megjithatë Nexhati e dinë, zyret e kryetarit i pranojnë drejtpërdrejt nga zyret, pra, drejtoritë si i binë ato. Nuk kemi ne të drejtë me i ndryshu. Ne kemi të drejtë me ja u paraqitë këtu. Musa e ngriti një çështje me vend tek çështja e inspeksionit. Tash kam kërku që, një inspektor ta kemi të shërbimeve publike. Për çështjen e gjeometrave, edhe 20 herë me shpall konkursin nuk të vjen askush. 3 herë e kemi shpall, ndoshta po e gjejnë veten shumë më mirë në sektorin privat, dhe ky trend më gëzon. Te çështja e inspektorit të uzurpimeve, shefit. E kanë bërë një shef të cilin me katalog po kërkojka aty që nuk po i kryen edhe çështjet e uzurpimit. Besoj që në kohë ka me u rregullu. Unë besoj se kemi me u kompletu rreth inspektorit të shërbimeve publike. Kontrata kolektive po na dëmton shumë, për shkak se e prishë strukturën buxhetore, pavrësisht se në përfundim të vitit ai ti qetë, por punët ngecin në rast se nuk ke mjete me i dhanë. Ai ta bjen fakturen dhe ti nuk ke me i dhanë, operatori ndalet. Këtu është pengesa. Strukturën buxhetore të cilën ju e keni aprovu, ajo ta prishë. Dje na kanë marrë 1 milion e 300 mijë, ato krejt i ka marrë nëpër projekte. Një çështje të ndjeshme e shtroj Taulanti për ujin e pijshëm. Taulant, e kam informu kryesuesin edhe në KPF, do të isha edhe në përfundim të karrierës politike njeri më i lumtur nëse e realizoj projektin i cili është veç në tenderim. Në tenderim është dhe ende nuk i besoj se kam shpenzu shumë kohë, kam humb shumë kohë e shumë mund, se unë drejt për së drejti jam marrë me të dhe tash e kemi një tender që ka qitë Banka Botërore prej 6.5 milion, që konsideroj që projektin e kam parë. Unë se kam njerin tim aty që merret, që do të jetë një fabrikë e re. Para fabrikes do të jetë për mënjanimin e turbullinave, do të jetë rezervari, plus një pjesë e saj. D.m.th 4 objekte që do të ndërtohen, që do të jetë për mbetjen e lymit. Vlera e këtij projekti është 6.5 milion, deri sa të lidhet kontrat edhe të fillon. Unë kam fillu me hup atë durimin. Në këtë drejtim falenderoj të

gjithë këshilltarët komunal që më kanë ndihmu në këtë drejtim, kur u kanë çështja me shpall. Çështja me interes të përgjithshëm. Faleminderit dhe prej Drejtorisë së Kadastrit, që çdo hapë e ka bërë në interes sa më parë dhe të financave me pagu, dhe kemi zanë hapin, se aty jemi në trend me Gjilanin dhe Kamenincen, por megjithatë aspektin e mbulimit administrativ, tu fillu prej meje si propozues e juve si vendimmarrës e deri në ekzekutiv nga ana e Drejtorisë së Financave, kemi qenë në afat rekord. Para pak ditësh e ka lëshu edhe një urdhëresë drejtoria, që Visari i ka kërku për me lëshu lejen e ndërtimit, dhe po besoj, shpresoj që do të bëhet. Te kallderma nuk jam i knaqt, me projekt shumë jam i knaqt që e kemi qëllu. Kur doni individualisht ju qes kafe dhe binduni që asaj është dashtë me ja bërë ashtu dhe duhet me ja bërë, dhe besoj edhe ju bindeni me ja bërë. A duhet projekti me u ekzekutu më mirë në plotni, pajtohem që duhet më mirë. Këto 5 fshatra i kanë disa defekte. Kemi nënshkru marrëveshje me “Hidromoravën” për me i marrë në menaxhim, për shkak të kualitetit të ujit. D.m.th ka ra mangani, por është formu një ekipë, dhe së shpejti do të delë në tender me i mënjanu ato dhe me fillu me hi në sistem të rregullt. Nuk kemi mujtë. Vitin e kalum është bërë kjo, por këto na kanë pengu. Këtu është ajo që pengon kontrata kolektive, na ka marrë kur na ka pru ata raportin që duhet me dalë në tender. Ne nuk kemi pas mjete për shkak të marrjes së parave. Çështja e policit të shtrirë. Është e vërtet që e ke shtru, është e vërtet që ka shtru edhe Ilir Zuka. Ai e ka me hjek, ti e ke me shtru. Drejtori i shërbimeve publike e potencoj që, nuk mundet kompania me dalë veç për një. Individualisht ti mundesh me quajt raport të mos punës, ne e kemi quajt raport të punës. Informata nuk është me i knaq apetitet individuale, informata është paraqitja e punës 1-vjeqare të një ekzekutivi i cili është ballafaqu brenda vitit. Tash a e knaq dikënd apo jo, a është shumë e pakënaqur apo pjesërisht, është çështje individuale e çdo këshilltari. Listën e investimeve kapitale e ke dhe te pasqyrat financiare. Ne bisedum edhe me kryesuesin e kuvendit, ne nuk deshtëm me ju maltretu, se në atë listë ne kemi pas programin që ka qenë 1 orë me i paraqitë të gjitha investimet kapitale që janë bërë në Komunën e Vitisë. Nuk ju kemi shmang kurrë, por u dakordum mos me ju maltretu me të, pasi që i keni edhe te pasqyrat financiare. Informacione kurr nuk keni dhanë. Unë nuk besoj që ka ekzekutiv më shumë se ne që kemi dhanë informacione. Po e përseris, para 3 - 4 seancave e kam thanë, në rast se kryetarin herë pas here e kemi pas mungesë, kemi pas të bëjmë me një nënkryetar që kurrë, asnjë seancë nuk ka mungu, dhe të gjithë janë mundu me ja u thanë dhe me përcjell tek ekzekutivi. Bile tash po ndërlihem, prej kur kam dalë nga seanca unë e kam thirrë drejtorin e shërbimeve publike, të njëjtën ditë edhe Kemurin, dhe ja kam tregu dhe shqetësimin tëndë, se në rrugë e sipër dikush ka pas një kërkesë dhe për Terpezë, dhe e kanë marrë si detyrë që duhet me kry. Tash më informove që nuk është kry. Tani duhet me u përsëritë. Sheshi është një realitet që nuk është kry, është në përfundim e sipër. Projektet të cilat janë 5-vjeqare, unë konsideroj Jakup që i shtjellum një here. Zakonisht projekte të cilat nuk po kanë pranim teknik, ato nuk pe ke qare pa i shty çdo vit, edhe pse figuron si i krym, deri sa të bëhet pranimi teknik, se ndalet një shumë e mjeteve, dhe kështu po ekzistojnë si projekte. Avokati a ka ndonjë landë që ka fitu. Unë do të kërkoj me pyet. Vetëm një e di, ki të bëjë me një njeri shumë ambicioz, profesional. Avokati kur shkon me mbrojt një lëndë, gjithherë dihet që pala që të ka paditë konsideron që komuna është fajtor. Hipotetikiisht dihet dhe tani shumicën elandëve ai ka me i humb se ata që të kan paditë ata e kan një bazë për që a ka fitu nodnjë landë nuk ekam pyet e di që është shumë profesional dhe ambicioz një djalë i ri besoj që në saecen e radhës ke me marrë përgjigjen unë ka me pyet. Në sa fshatra ka ujë të pijshëm. Të gjitha ato që menaxhohen nga “Hidromorava”. Ne e dimë që edhe Kabashi ka ujë të pijshëm, por nuk e menaxhon “Hidromorava”, e menaxhojnë në formë të vetë, dhe unë konsideroj që nuk është në konturat që duhet me qenë. Te rryma, ne nuk jemi kompetent në atë çështje, presionin e kemi bërë të vazhdueshëm, e dinë Muslia. Kur i kam thirrë nuk kam pranë vetë me bisedu. Kam thanë që do ta thirri një përfaqësues të lagjes, për shkak edhe të pozitës që kishte institucionale. Ne ju kemi drejtu me shkresë, atë që është dashtë të bëhet e kemi bërë. Taulant, gjendja është kjo që është, jo e pëlqyeshme dhe për mua, por më tepër nuk kemi mujtë me bërë. Kur ka qenë në pyetje KEDS-i për me ja dhanë pronën, ju e keni kry gjithëhere në bashkëpunim me neve. Ne kemi pru propozimin, ju kam thanë tash e tutje ndoshta kjo nuk do të kaloj, se mirësinë tonë të cilën e kemi përdor për shumë vite ndaj jush, ju po na e keqpërdorini, por megjithatë ato i kanë ato planet e veta, po duhet me shku në Prishtinë me marrë prioritetin. Kujna me i dhanë përparësi, megjithatë konsideroj që nuk kena arsyeshmëri për shkak se momentin kur e pagun rrymën, duhet me i dalë edhe qytetarëve në kryerjen e shërbimeve.

z.Taulant Haxhiu: Nenkryetar, zakonisht ne edhe në kompani tona bajmë një informatë, dhe informata kur na vjen prej agjendëve të shitjes, llogaritmi shitjen, profitin dhe humbjet. Tregom ti mu, ky sheshi që është zgjatë në Komunën e Vitisë, çfarë dobie i ka pru ai qytetarëve dhe bizneseve përreth dhe e ka blloku komplet qytetin e Vitisë. A u rritë lëvizja e qytetarëve. Po mbyllen kafiteritë, ka mbet veç një kafiteri në shesh, veç kallxom çfarë pozitiviteti dhe çfarë progresi ka pru stergjatja e sheshit dhe bllokimi i qytetit të Vitisë, dhe e ka pa kualitetin çfarë dallimi ka sheshi i ri me sheshin e vjetër, punimet dhe cilësinë. Rruga me kalldrëm. I nderuari nënkryetar, nuk jam kundër investimeve, veç trego ti me veturë ku të kalojsh, a e ke pa si ndjehesh dukë vozitë se çfarë cilësie ka ai kalldrëm. Aty çka ka pas progres, çka i jep bukuri, a e shfrytëzojnë qytetarët atë kalldrëm që u vendos aty. Zakonisht kalldrëmi është për ecje, për mu pa, nuk është për me hecë veturat. Unë nuk di që shtrohet kalldrëmi për lëvizje të automjeteve. Veç tregomi profitet në këto investime që i kemi pas ne dhe qytetarët e Komunës së Vitisë, një elaburim për sheshin dhe për rrugën me kalldrëm.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Taulant, më vjen keq që nuk ke qenë këshilltar i kuvendit komunal. Po harroj vitin, në mandat e mëhershme që plani i mobilitetit e ka parapa në këtë formë dhe u votu në kuvend nga asamblistët. Në rast se nuk është kështu, unë të jap ty çfardo llogarie. Në atë kohë ata e kanë pa në atë formë, ka pas edhe konsulent të jashtën që e kanë mat dhe kanë thanë që sheshi duhet me kalu prej postes, dhe kjo pjesë që është bërë dhe u bë. Te çështja e kualitetit, kanë me fol inxhinerat, por mos harro se, do herë e ke pas kritiku dhe sheshin nalt, ke thanë kualitet i dobët. Tash paska dalë ai i mirë ky i keq. A po pajtohesh me këtë që plani i mobilitetit ka qenë i votum në kuvend. Ne e kemi implementu, ka pas dhe debat me qytetarët, a është qëllu a nuk është qëllu. Nuk shtrohet pyetja me kritiku. Te cilësia. Jam për me përmirësu. Te çështja që qe sa ka filli, qe ku është inxhieneri dhe e dinë ky që, kur është dashtë me u përfundu. Te çështja e kalldrëmes. Unë kam qenë idhtar i madh i asaj pune. Duhet me ndryshu atë mentalitet. Vitia duhet të ju kthehet qytetarëve, atyre që jetojnë këtu.

z.Nexhat Halili: Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë deklaroi dhe tha që, konstatimet e mia nuk qëndrojnë, mirëpo lus drejtorin e drejtorisë ne ta merrë raportin 6-mujor dhe raportin vjetor, ta bëjë krahasimin dhe të shfajtoj copy-paste është drejtor. Tash në 6-mujorin e dytë, nëse nuk është punu të paktën punëtorët kanë marrë pagën e dytë, mos në paqin punu të tjerët, sektori, njësia e zjarrfikësve ka punu drejtor. Merre, krahasoje, kqyre raportin e shfajtoj se si është. Te ndriçimi publik deklarove se është mbikëqyrësi këtu, por mbikëqyrësi nuk është tani në sallë, iku, shkoj, por nëse mundesh ti me na dhanë një përgjigje ka qenë mirë. Nënkyetar, diferencat që i kam deklaruar janë diferenca që i kam marrë mes pasqyrave financiare dhe raportit të kryetarit. Kemi pas edhe te Drejtorja e Financave me raport të kryetarit, me pasqyra financiare mospërputhje, por këto pika tjera që janë kompetencë të kryetarit, Zyra Ligjore nuk ka paraqitë hiq raport. Ki edhe disa njësi tjera që nuk kanë paraqitë raport. Për këtë arsye pyetjen që parashtrova te avokati i popullit, a ka pas të drejtë të nënshkruaj këto 4 kontrata për dhuratëmarrëse, nuk mu kthy përgjigjja. A e ka të drejtën kryetari apo ai zyrtari. Unë mendova se në pasqyrat financiare do të shtroja edhe pyetje tjera, po unë tash po potencoj edhe e potencum më herët për trotuarin i cili lidhë Trestenikun me Sllatinën. Është e vërtet që kam potencu gati në të gjitha seancat. Ky trotuar ka mbetë në mesë të rrugës. Distanca e këtij trotuari është 2756 metra, deri tani veç 50% është kry ky trotuar. Del një operator ekonomik 1 ditë para zgjedhjeve dhe 1 ditë mas zgjedhje, ka kry do punë skajore, mirëpo në këtë trotuar kan fillu të paraqiten brejtës, hardhuca, bretkosa, sepse ka mbetë në mëshirën e fatit.

z.Illir Zuka: Nënkyetar, kur e ceka për kontratën kolektive, a ka ndiku mos kryerja e sheshit dhe shumëpuneve tjera për shkak kontratës kolektive. Është edhe mbikëqyrësi këtu, Florimi, kam diskutu disa herë, e di që ka pas shumë pak buxhet ose me thanë hiq të ndamë, dhe nuk ka mujtë me kry. Nëse është diçka tjetër, unë besoj që duhet me marrë masa ndaj asaj firme.

z.Remzi Salihu: Nënkyetar, po ndërldhem te uji i pijshëm që thatë se, në të gjitha fshatrat që i menaxhon "Hidromorava", uji është i pijshëm, pa më dhanë shifër se në sa fshatra. Pyetja tjetër: uji a është i pijshëm në 5 fshatra të cilat menaxhohen nga "Hidromorava"? Trestenik, 2 sllatinat, 2 sodovinat. Edhe te avokati që parashtrova pyetjen, më the se, në seancën e ardhshme do të ma kthejsh përgjigjen. Faleminderit, por në pyetjen tjetër për kryetarin, nuk më the se a do të ma kthejsh përgjigjen apo do të ja përcjellë pyetjen që e bëra, edhe po kthehem prap te avokati. Unë nuk dyshoj dhe nuk vura në dyshim profesionalizmin e avokatit, por unë vetëm

pyeta për punët që ai i ka bërë, dhe as që dyshoj që ai nuk ka aftësi t'i kryen punët që i ka marrë në përgjegjësi dhe për të cilat paguhet.

z.Jakup Demiri: Nënkrejtari, për rrugën me kubza nuk kemi çka diskutojmë. Në fotografi duken mirë, por kemi fol dhe gjatë implementimit të punimeve këtu dhe thojshë se është shumë mirë, dhe po na vijnë qytetarët në zyre, po na urojnë për këtë projekt që është shumë interesant. Si e keni mëndu dhe qe qysh e keni, ndërsa te projektet me nga 5 vite, nuk po flasim për projekte, se tash te aspekti kur e kemi votu buxhetin, nuk ka të bëjë kjo me pranim teknik që nuk e ka, po janë 27 projekte të cilat figurojn në atë listë, që i kontrabandojshi ju, se këtu listën na e keni pru 5 minut pa e votu buxhetin. Unë i kam pas nxjerrë dhe më herët, tash janë në 2022, kanë fillu në 2023, janë në buxhet të aprovume, prapë të ndamë në buxhetin e 2025 dhe në parashikimet e 2026, 2027. Për këtë jam tu fol, nuk jam tu fol për projekte të cilat pse nuk ka pranim teknik. Ne jemi tu fol për projekte që jemi tu i nda pare dhe në parashikime i kemi për me i nda pare, ndërsa Ilirit ju kisha përgjigj, nuk ka nevojë me i ndihmu në këtë aspekt komunës për me i arsyeu zhagitjet e projekteve, se me grand të performancës nuk e di që e ka problemin financimi i buxhetit. Këtë punën e sheshit këtu, po ato trotuaret qe 4-5 vite që nuk keni rahmet as për fëmijët që mund me humb jetën aty. A kontrata kolektive ju ka pengu a? Jam tu fol për papërgjegjësi totalte të komunës ndaj fëmijëve, më së pari që hecin aty pari dhe të disa pleqve që e frekuentojnë edhe natën me shku në xhami. Ata atë aktivitet e kanë dhe ata janë të rrezikum, se ndriçimi natën nuk ju bënë, por ju bënë në mëngjes, dhe kjo qe 3 vite zgjatë. Folni për përgjegjësi që ju takojnë. Ndrçimi publik paguhet prej taksave të qytetarëve. Përgjegjës jeni ju, nuk është tjetër kush. Ai funksionon ditën, është viti i 3-të, e mos të flasim për projekte që në telefon i kam, dhe tjera projekte, që mund të ja u tregoj me foto. Qe në Smirë, vitin e kaluar është shtruar kjo rrugë dhe shikoje sot. Bekimi e dinë si është kjo, është bluar krejt. Shkojnë shtrojnë asfalt, merren vesh me 2-3 vetë për vota, se unë i di dhe muhabetet që jan bë me ato familje. Flasim nënkryetar për projekte, po flas përnjemend që kemi të fillum në 2022, të buxhetume në 2025 dhe në parashimet buxhetore për 2026, 2027.

z.Ilir Zuka: Jakup, po kërkoj që mos me shtremu atë që thashë. Qoftë se është fajtor kompania, që nuk i ka kry punimet, ju si institucion duhet me marrë masa. Në qoftë se është diçka tjetër, ne të merrë masa kush e ka bë atë. Realisht a është dashtë të kryhet vitin e kalum, nuk është kry. Dikush është fajtor, këtë thashë. Por që keni dëshirë me i shtrembu, është diçka tjetër.

z.Jakup Demiri: Ilir, nuk është problemi ky, por është problemi që kemi diskutu këtu, që projektet po zgjasin shumë, nuk po kryhen kurrë, edhe është problem që duhet me u mobilizu, se në Viti për 1 vit jemi maltretu krejt me këtë problem. Nuk po themë që është me ndonjë lokalitet që nuk bënë pengesë shumë, por dhe 2 herë mërgimtarët, edhe veres edhe dimrit janë maltretu me këtë. Për këtë po themë që duhet me u mobilizu mirë me kry punën.

znj.Majlinda Shabani: Tek lista e investimeve kapitale, nënkryetari tha që: nuk e kemi vendos me qëllimin që nuk kemi dashtë me ju ngarku. Mirëpo, ne e dimë që për secilin vit në raportin... nuk e kemi vendos në raportin për periudhën, por e keni te pasqyrat financiare, sepse nuk kemi dashtë me ju ngarku më shumë, meqenëse e keni aty. Te lista e investimeve kapitale. Ne e dimë që në secilin raport vjetor të paktën kemi pas listën e investimeve kapitale, edhe pse ajo listë shpeshherë ka pas mospërputhje me kohën për të cilën kemi qenë tu raportu. Edhe nëse e ke vendos tek pasqyrat financiare, mandej e kem pas mundësinë ku kemi has dhe mospërputhje mes raporteve dhe pasqyrave financiare, siç ndodhë edhe në këtë raportim vjetor. Tek investimet kapitale që bëhen, dhe cilësinë e dobët, dhe për këto çështje që folëm, je dëshmitar dhe jemi dëshmitar që sa herë është dashtë me intervenu në rrugë dhe në asfalte, që të paktën ndoshta 1 vitë që janë shtru dhe janë asfaltu. Çështja tjetër, ku e permenda punën e aspektit politik, rezultateve të zgjedhjeve dhe ikjen ose friken prej përballjes që thashë unë në këtë drejtim, atëherë unë mundem me kuptu rastin që ka mujtë me pas kryetari i komunës, mirëpo megjithatë ai duhet me mbajtë përgjegjësi, dhe të paktën ka mujtë nja 2 orë sot me ardh kur është tu diskutu raporti i punës, si njëri prej dokumenteve më të rëndësishme, sepse në as edhe një here nuk e kemi kryetarin prezentë në kuvendin komunal, përpos kur diskutohet raporti i punës dhe kur të votohet Buxheti Komunal i Vitisë. Unë kur them prej pushteti lokal e tona këto gjëra që cekim, unë të garantoj nënkryetar që, nuk jam tu fol vetëm me fjalë të mia, por po flas prej asaj që kemi pas në teren. Unë nuk e di a je në dijeni, po ta

përmendi si rast që, pas 3 dite që kanë përfunduar zgjedhjet lokale, kryetari i komunës, Sokol Haliti ka lëshuar një urdhëresë për të gjithë zyrtarët publik, që të respektohet orari i punës. Tash a i bie që nuk ka qenë tu respektu orari i punës? Sepse, tash kur nuk i vjen keq dhe nuk i vjen marrë kryetarit Haliti, të gjithë zyrtarët publik me i shfrytëzuar për fushatë, dhe të gjithë familjarët e tyre me i detyru me dalë në takime dhe tubime, pse duhet me më ardh mu keq me ja përmend këto para kuvendit komunal.

z.Musli Neziri: Nën kryetar, për punën e inspektorave, meqenëse aty bëra pyetjen, sidomos te inspektori i shërbimeve publike. Arsye më ka shti me kërkun që në vendin ose objektin që janë disa parti politike, që ne jemi dhe si PDK, dhe çka është më interesante është dhe organizata e veteraneve të luftës në krye që ka ardh OVL me drejtuesin e ri. Aty mendoj që nuk është mirë me pritë ndoshta hiq inspektorin, por është mirë me u mirëmbajtur objektin sepse është në gjendje shumë të keqe, tu e ditë asaj që kalim një proces zgjedhor, fushata, organizata e veteraneve të luftës ka pas shumë vizita prej deputetëve, ish deputetëve dhe kryeministrit në detyrë, ka qenë, e ka vizitu aty dhe nuk ka asgjë të keqe që e kanë vizitu, mirëpo gjendja është shumë e keqe nga aspekti sanitar i tualeteve. Aty mungon uji, është shumë keq, jo e mirëmbajtur, atëherë kisha kërkun dhe kemi pas si kërkesë prej tyre që të bëhet diçka rreth asaj, të intervenohet shumë shpejt.

z.Basri Aliu, drejtor: Nexhat, me shumë respektin unë thashë që 6-mujori i parë hynë dhe në 6-mujorin e dytë. D.m.th hynë edhe ato të dhëna, se është problemi për vitin 2024. E ke prej faqes, a ka ndryshime a nuk ka për me ta sqaruar tek buxheti i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë. Shikoj pra, a janë të krahasueshme numri i njëjtë me janar-qershor, atëherë ma thuaj, a është e shkruar atje 93% i shfrytëzimit të buxhetit. Pse nuk e përmend Nexhat, p.sh.: që diku Drejtoria e Shërbimeve Publike mbi 500 mijë euro ka marrë investime. A janë të shkruara atje 2 trajnime që janë bërë për emergjencë. D.m.th kjo nuk qëndron.

z.Nexhat Halili: Drejtor, të lutem merre krahasojë 6-mujorin e 2024-ës me vjetorin e 2024-ës. Të gjitha këto të dhëna që i ka në 6-mujorin e 2024-ës i ka edhe në vjetorin e 2024-ës.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Unë jo që i kam ik. Nuk qenka bashkëvendasi im, profesori. Unë pyetje provokative ku ka qu asfalt, ku nuk ka qu nuk mirra me përgjigje, sikur që nuk merrem Majlinda, se nuk je aspak korrekte. E ke diku nja 8 vite kryetari i komunës, çdo fillim viti qon edhe urdhëresë për respektim të orarit të punës për çdo vjet dhe respektim të ligjshmërisë. Këtë ta dokumentoj kur të duash, jo vetëm sivjet, për çdo vit. Është praktikë e tij. A është e mirë apo nuk është e mirë, ai e shef ashtu, ajo është e drejtë e tij. Kalldrëma. Nuk ka qysh ka emrus më të përbashkët në kualitet, nuk jam i pajtun, po gusat dhe thitë që je mësu me i pa Taulant, ti kam hjek, nuk i ke më hiq aty, edhe atë rrugë nuk e ke më.

z.Nexhat Halili: Unë e kam një koment. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente ka tjetër raport. Neve si asamblist na u ka dërguar tjetër raport.

z.Jakup Demiri: Për këto çka i tha Nexhati, kemi punë bashkë. Nuk është veç raporti i parë ky copy past prej shumë drejtorive. Në secilin vjet, në secilën informat të kryetarit dhe te pasqyrat financiare, madje ja u dëshmojmë këtë, ndesh e lajm pikë të rendi të ditës për mbledhjen tjetër në Komunën e Vitisë. Kur nuk është kryetari, këtë raport nuk ka nevoj me mbrojt as nënkryetari as kërkush. Një mbledhje e kam lëshuar për shkak që nuk ka qenë kryetari, ka ardh me vonesë. Kryetari i Komunës së Vitisë nuk ka as planifikim të investimeve kapitale, nuk është kërkush përgjegjës për këtë punë, dhe jeni krejt pa faj. Po keni përgjegjësi, se keni marrë detyra, se ai nuk ju vetë bash hiq, borxhet ju kanë shku mbi 2.5 milion euro. Edhe vitin e kalim keni pas borgje. Unë kamë bë pyetje këtu, në seancën e fundit disa obligime ju kanë mbetë, se në disa operator kemi familjar, por keni marrëveshje të shkruara me miliona euro si tinxa, se transparencë nuk ka absolut. Komuna e Vitisë shkon drejt kolapsit financiar, d.m.th kemi me pas problemin këtu, jemi këtu, kemi me qenë. Pasqyrat financiare në raportin e kryetarit nuk janë kërkund. Qeto raporte nëse i ka marrë kryetari i ka marrë prej qatij njeri, sikur pasqyrat financiare nuk janë askund nuk bazohen, madje buxheti në shtator nuk na u ka barazu. Ne e dimë për krejt çka jeni tu folë, janë të vërteta, por duhet edhe gabimet me i pranuar. Ne e kemi për detyrë këtë me ju korigju, ju kemi korigju me sinqeritetin më të madhë. Unë për veti mundem me folë. Këto rrugë, këto cilësi janë kështu siç janë. Faji është më së pari tek ai që e ka bë projektin si i ka parapa shumë sene, dhe kur të hynë në projekt ne e dimë se na bjen edhe me inxhiniera. Kemi edhe njerëz inxhiniera shokë dhe familjar që nuk janë të kyqen, por i dimë problemet. D.m.th kur të hynë inxhieri punën më të madhe e ka tana me operatorin, me ja rregulluar edhe

letrat edhe projektin, se nuk është askund. Po më së pari kur jepen tenderat, jepen me dallavere. Shumicën prej tyre besoj që i dimë kush i fiton, kush i merrë, kujna ju jepen, madje edhe në konkurse. Për shumë konkurse kam bisedu, veçmas me nënkryetarin që, filani shkon këtu. Ani thojsha priti, dhe po valla shkoj. Këto janë veç transparencë, ligj dhe rregullaritet që përdor kryetari. Nuk ka edhe kur nuk është kryetari ne veç humbim kohë, se mes veti krejt jemi sa drejtori aty sa unë përgjegjës për krejt këtë punë çka bëhet, se nuk e vetë asgjë dhe e dinë edhe ai e pranon prej qetuhit që dalim secili prej drejtorëve. Këtu është një autokraci që sa vite e instalume, Qytetari i Vitisë elementet bazë të jetës qëtu prej qeverisjes komunale nuk i ka, nuk ka ujë të pijshëm, nuk ka shërbime shëndetësore cilësore, nuk ka administratë komunale në nivel. Këto sene i ka, ndesh i pranum ndesh jo. Në fund qytetari i banë në rruzen e vet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kjo pikë nuk votohet, vazhdojmë me pika tjera.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-dhjetor 2024

z.Berat Zuka, Zyrtar financiar: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Për shkaqe shëndetësore të drejtoreshës, mu ka besu mua që ta prezantoj raportin financiar nga 1 janari deri me 31 dhjetor për vitin 2024. Ne si zyre e buxhetit dhe përgjegjës në bazë të Ligjit për Manaxhimin e Financave i kemi përgatit 2 parë pasqyra financiare. Kjo çka ju ka prezantu delegatëve të komunës dhe raporti financiar të cilën e dorëzojmë në Ministrinë e Financave, që ka një format tjetër. Shihet në raportin financiar se, aprovimi i grandeve qeveritare nëpër kategori ekonomike edhe mundet me thanë dikush se ka mos harmonizim të grandit qeveritar, sepse me aprovimin e draft buxhetit të vitit 2024 grandit qeveritar ka qenë 15 milion e 613 mijë e 689 euro. Të hyrat vetanake kanë qenë 1 milion e 29 mijë e 502 euro, kurse nga të hyrat e aprovimet që janë të bartura nga viti paraprak, të pashfrytëzuara kanë qenë 454 mijë 270 euro, nuk janë të prezantuara në planin e buxhetit dhe donacionet edhe të DEMOS-it dhe donacionet e Unionit European prej 513 mijë 762 euro, çka do të thotë që, buxheti i alokuar në fund të vitit 2024 ka qenë 19 milion e 945 mijë e 563.27 euro. D.m.th është një diferencë vetëm te grandit qeveritar, prej 2 milion e 324 mijë e 340 euro. Kjo diferencë është aprovuar sikur e dimë që kemi pas shqetësime edhe ju të nderuar delegat. Problemi ka qenë i mos ekzekutimit të pagave nga muaji shtator, tetor, nëntor, dhjetor, qeveria e ka plotësu në fund grandin qeveritar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Buxheti i aprovuar është i njëjtë me buxhetin e alokuar, çka do të thotë se, draft buxheti ka qenë 16 milion e 653 mijë e 192 euro, mirëpo ndryshimet kanë psu nga fondi burimor 22 dhe donacionet kanë arritë shumën 19 milion. Buxhetin e shpenzuar në fund të vitit nëpër kategori ekonomike dhe fondet burimore po i përmend vetëm totalin e këtyre shpenzimeve, që për paga është 99.95%. Që d.m.th që ka qenë 100%, mirëpo me 27 janar është bërë një kthesë e një punëtore të lehonisë te stafi shëndetësisë prej 1138 euro, kateogria e mallrave dhe shërbimeve është 98.84%, komunalit 95.56%, te subvencionet 98.84%, te shpenzimet kapitale 97.22%. D.m.th total buxheti i alokuar dhe i shpenzuar është 99.15%. Nga faqe 3 dhe faqe 4 i keni të gjitha pasqyrat e ekzekutimit nëpër kode dhe nëpër kategori ekonomike që janë të përgjegjësuara në total. Kështu që, ju kisha lutë që, nga faqja 5 deri në faqe 18 janë të përgjithësuar të gjitha nëpër drejtori, ku drejtorët janë autorizues të buxheteve, dhe drejtorët mund të ju bëni pyetje për arsyetimin e këtyre shpenzimeve, sepse pa inicimin e drejtorit asnjë shpenzim nuk mund të fillohet. Në faqe 19 dhe 24 i keni të hyrat buxhetore komunale të planifikuar dhe të realizuara për periudhën janar, çka do të thotë se, në total të hyrat janë prej 119.78% të realizuara, d.m.th kanë qenë 1 milion e 29 mijë e 502 euro të realziuar. 1 milion e 233 mijë e 158 euro janë të realizuara, duke i përfshirë edhe të hyrat indiriket, që do të thotë të hyrat çka rrjedhin nga niveli qendror, kurse nëse i marrim planifikimin e të hyrave prej 1 milion e 29 mijë e 502 nga tatimi në pronë dhe tokë janë të realizuara, shuma prej 72.62%, kurse të hyrat jo tatimore janë prej 118.98%, por në totalin edhe të hyrat indirekte çka janë bartur komunës nga niveli qendror, të hyrat e gjykatave dhe të hyrat e gjobave të policisë kapin shumën prej 119.78%. Në faqe 21, 22 i keni krahasimin e të hyrave vetanake për periudhën janar-dhjetor 2024. Shohim këtu se, te tatimi në pronë kemi krahasimin e të hyrave të vitit 2023 me 2024, minus 295 mijë euro e 586.96, që d.m.th se norma e tatimi në pronë ka ndiku. Mirëpo ka ndiku edhe mos qasja e përmbaruesit privat çka kemi informacion nga zyrtari i tatimit në pronë, se të drejtën e ndalesës përmes bankave do ta ketë zyrtari i tatimit në pronë për ndalesë të qytetaret, dhe besoj që kjo shumë

vitin e ardhshëm nuk do ta ketë këtë diferencë negative. Pos këtij materiali, kisha me thanë që vitin e kalum u bë nëpër media që komuna nuk ka planifikuar për kontraten kolektive. Ju e dini që, me qarkoren buxhetore dhe kryesuesi, se me qarkoren buxhetore nuk parashihet asnjë planifikim, asnjë send i kontratës kolektive. Vendimet gjyqësore janë paguar përmes pagesave direkte nga thesari, në vlerë prej 3 milion e 293 mijë e 644.41 cent. Për paga jubilarë është shumë prej 3 milion e 104 mijë e 946.58, kurse shuma prej 188 mijë e 697.88 euro janë pagesa tjera për shpenzime kapitale dhe pagesa tjera mallra dhe shërbime. Në fund e keni dhe një material, një listë plotësuse me kode, për emërtime të shpenzimeve, që besoj që, kjo ju ka letu më shumë për me i pa shpenzimet. Pra, janë të tërësishme. Drejtorët janë prezent dhe do të ju arsyetojnë arsyen e shpenzimeve nëpër programet e veta.

z.Nexhat Halili: Në bazë të elaburimit të pasqyrave financiare për janar-dhjetor 2024, po orientohemi pak tek të hyrat vetanake gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, inkasimi i të hyrave vetanek është në vlerë prej 1 milion e 233 mijë 158 euro e 14 cent. Shkalla inkasimit bazuar në planifikim është 1 milion e 29 mijë e 502 euro, shkalla e realizmit sipas Drejtorisë së Financave është 119.78%. Krahasimi i të hyrave vetanake në periudhën janar-dhjetor 2023/2024 të të hyrat vetanake 2024 janë më të vogla se në vitin 2023, në vlerë prej 20933.29 euro ose 19.52%. Në faqe nr. 20, te pika 11, ku përfshihen të hyrat në vlerë prej 296407 euro janë paraqitë vetëm shkalla e inkasimit po jo edhe e planifikimit të shpenzimeve indirekte. Zyrtari kryesor financiar, atëherë në bazë të llogarisë, duke mos përfshirë totalin e të hyrave tjera, shkalla e realizmit është pak më ndryshe, nuk del 119.78%, po del diku 91%. Po t'i shtohen të hyrave vetanake edhe vlerat që ti i potencove, të hyrat e bartura prej vitit të kalum dhe të donacionet, atëherë del përqindja shumë më e ulët. Ky trend i mos planifikimit për të hyrat e tjera është praktikuar nga viti 2021, ngase deri në vitin 2020 janë parapa edhe si të planifikume dhe realizume. Më brengos fakti të të hyrat vetanake për tatimin në pronë, ku vlera e mos inaksimit është 169 mijë e 862 euro e 86 cent. Unë i kam potecu vetëm 3 që janë më të larta: tatimi në pronë, plani gjeodezik dhe kopjet e planit. Diferenca është 19 mijë e 161 euro, dhe taksa për legalizimin e objekteve që janë 19 mijë e 126 euro e 73 cent. Këto janë 3 të hyrat vetanake më të ulta se sa të planifikume. Tash po përqendrohemi te shpenzimet buxhetore. Gjatë analizës së pasqyrave financiare shihet se, buxheti i planifikum për vitin 2024 ishte në vlerë 16 milion e 653.191 euro, kurse buxheti i aprovuar dhe i alokuar është 19 milion e 945563.27 euro, kurse buxheti i shpenzuar është 19 milion e 775 752.92 euro. Kjo është një diferenc mes të planifikimit dhe të aprovimit. Unë po potencoj te vendimet gjyqësore gjatë vitit 2024 janë 3 milion e 293 794.41 euro, që në përqindje, krahasim me shpenzime është 16.66%. Unë e kam bërë një krahasim te vendimet gjyqësore për investimet kapitale, vlera prej 519 mijë 358.15 euro, kur të krahasohet me vlerën e investimeve kapitale 3 milion e 840342.46 13.53%, që kanë ndiku vendimet gjyqësore në investime kapitale. Kodi 1340 sherbime te ndryshme shëndetësore 511 mijë e 359.69 euro. Në këtë kontratë është përfshirë kontrata e KARITAS-it, por pyetja ime është kështu. Në kuadër të kësaj kontrate a përfshihen pagesa e punëtorëve, ku me ligj të buxhetit nuk lejohet pagesa e punëtorëve. Tek investimet kapitale, rregullimi i hapësirave gjelbruese në pozicionin nr. 1 dhe nr. 4, ku i kemi 2 operator të ndryshëm, kanë vlera të ndryshme. A kanë dikush me elaboru këtë pozicion, pse janë kështu. Përveç këtyre kemi dhe pozicionin numër 5, ndërtimin e ujësjellësit Ramjan, Novosellë, dhe pozicioni nr. 11, ndërtimi i ujësjellësit në Ramjan dhe Novosellë, vlerat janë 60 mijë për të paren dhe 60 mijë për të dytën. A mund dikush të ma shpjegoj, pse është bërë ndarja e këtyre pozicioneve. Unë e di të paktën, se ekzistojnë kontratat, por pse ndarja e këtyre. Kemi rastin tjetër, te ndërtimi i ujësjellësit në Devajë dhe Radivojcë, edhe këtu është i njëjti operator, e ndryshëm pershkrimi i njëjt. Pse ndodhë kështu? Pozicionet nr. 6, 7, 8, ndërtimi i kanalizimeve, a kanë të paktën të dimë: çfarë kontrate ekziston për rregullimin e kanalizimit dhe në rregullimin e këtyre 3 pozicioneve? Cilat projekte ekzistojnë që kanë bërë rregullimin e kanalizimit? A janë ndarë fshatrat me një pjesë njanin pozicion, pjesën tjetër pozicionin e fshatrave tjera apo si është vepru? Ndërtimi i palestrave sportive shkollore, "Kuvendi i Lezhës" në Viti dhe shkolla fillore Sllatinë e Epërme. I njëjti rast po përseritet edhe pozicionin nr. 23 dhe 26. A bënë ta bëjmë një dallim, të specifikohet ashtu si kërkohet, se po e di që njana palestër është te "Kuvendi i Lezhës", tjetra është në Sllatinë. Tash sa është kontrata për njëren e tjetrën. Këtu janë potencu të dyat. Njëra është 40 mijë euro, pozicioni 26 dhe pozicioni 23 është 60 mijë euro. Ne po duhet me identifiku përmes operatorit ekonomik, se cila është në Sllatinë, cila në Viti. Asfaltimi i rrugëve rurale, pozicioni nr. 33. Në kuadër të kësaj a mund ta dimë cilat rrugë

janë, çfarë kontrate janë, 2 apo 3 vjerçare apo cilat rrugë përfshihen? Tash po e analizoj. Në fshatin tim ka rrugë shumë. Një rrugë është shtru pak më herët, por kanë mbetë shumë pa u shtru nuk e di a janë në kuadër të këtij projekti këto rrugë. Në vitin e kaluar, në seancën e prillit kam bërë pyetje për një rrugë, për një hendikep dhe kam ardhë në zyrat e juaja. Nënkrjetar, ju kam lutë me shtru këtë rrugë, për shkak se ajo rrugë është në shërbim publik, por nuk është marrë asnjë hapë në këtë drejtim. Ndërtimi i trotuarve dhe ndriçimi publik, pozicioni nr 35. Edhe këtu nuk po dihet. Unë e di që në fshatin tim trotuari ka mbetë në mes të rrugës, nuk është duke u punu, shihet një operator ekonomik e potencova më herët, një ditë ka punu para zgjedhjeve, një ditë pas zgjedhjeve dhe ka lanë punën, edhe pse po ju themë sinqerisht, nuk keni kontratë me kry atë projekt, kontrata ju ka skadu në 2023. Nuk e di në bazë të çkahit vjen punon, keni kontrakter, por për punë të tjera jo për këtë pjesën që ka mbetë, keni kontratën ku ka mbetë atje me vazhdu rrugën, ku ka mbetë për 720 metra pjesën tjetër. Ndërtimi i rrugëve me zhavor, edhe këtu nuk dihet se në cilat rrugë më së pagu duhet ta specifikoni. Ne me mujtë me i gjetë te kontrata i gjejmë, po këta asamblist nuk e kuptojnë se cila rrugë është e shtrume me zhavorr, asfalt, cili trotuar, cili kanalizim, ujësjellës. Te obligimet e papaguara janë 2 milion e 537563.43 euro, ku shërbime, mallra 544 mijë e 82 euro, shpenzime komunale 11 mijë e 786 euro, shpenzime kapitale janë 1 milion e 958 mijë e 778 euro dhe subvencione, transfere 2290016. Të hyrat nga rritja e buxhetit nga të hyrat vetanake janë 203 mijë 656 euro. Këto a nuk kanë mujtë me i shpenzu brenda vitit 2024 për këto projekte, por barten për vitin tjetër. Knej paraqitet që ka obligime, knej thuhet që kemi tepricë të mjeteve. A mund ta shpjegoni?

z.Taulant Haxhiu: Te shpenzimet, kodi 13503 kompjuter, d.m.th kompjuter keni bërë gabim në shkrim. 44 mijë e 730 euro po më duket shumë. Edhe kjo mobilje 13501 92 mijë e 785 euro, furnizimet në zyre te kryetari 6481 dhe mirëmbajtje të automjeteve 36 mijë e 163. Unë dua ta di sa automjete i ka Komuna e Vitisë që bajnë 36 mijë e 163 euro. Në kompaninë time i kam 44 vetura, kam shpenzime, heci në krejt Kosovën. Shpenzime kam pas në 2024 15 mijë e 108 euro. Këto janë të dokumentume. Këto 36 mijë e 163 euro, po më duket vlerë e madhe për mirëmbajtje.

znj.Majlinda Shabani: Në mbledhjen e KPF-së ne kemi kërku për disa kode buxhetore, ku po thu që janë në listën shtesë, mirëpo edhe nëse marrim me pa këtë listën shtesë, prapë janë po emërtime të njëjta dhe nuk ka sqarime për kodet specifike. Shpenzimet që janë bërë, kemi pasë kode të reja që kanë qenë shepnzime shumë të mëdha dhe të papranueshme, dhe kemi lypë sqarime për ato kode buxhetore. P.sh.: është shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse. Keni marrëveshje me AZHR-në lidhje për realizmin e akviteiteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal dhe rajonal. D.m.th i ke 2 shërbime të ndryshme intelektuale këshilldhënëse, njëra në vlerë 24 mijë euro, tjetra 120 mijë euro. Madje prapë ki shërbime tjera, kod tjetër buxhetor, konsulentë dhe kontraktor individual, prapë 43 mijë e diçka euro. Unë nuk e di se çfarë shërbime intelektuale dhe këshilldhënëse janë tu dhënë në Komunën e Vitisë, dhe sa ka qenë e nevojshme që me u shpenzu tërë ky buxhet për këto shërbime, dhe në anën tjetër e shohim se sa zhvillim kemi në Komunën e Vitisë dhe sa jemi tu pas projekte të reja në Komunën e Vitisë. Janë dhe kode tjera që kam kërku, sqarime shtesë, mirëpo nuk janë dhanë informacione. D.m.th janë po të njëjta dhe kjo është njëra prej kritikave të vazhdueshme që e kemi, dhe nuk kisha hi me i specifiku me rend, por janë disa shpenzime që janë shumë të mëdha dhe nuk keni dhënë sqarime konkrete se ku kanë shku.

z.Rezmi Salihu: Te prezantimi analitik i investimeve për periudhën janar 2024, d.m.th si investim kapital paraqiten edhe vendimet gjyqësore, që sipas meje ose duhet të emërtohen ndryshe ose unë i konsideroj këtu si investime të kota, jo investime kapitale, sepse ato shkojnë për një destinacion tjetër, dhe mundësi e keqpërdorimit që u tha më parë, mund të jetë edhe te shkaku që unë e kam parë këtu në këtë listë që është e emërtume kësisoji. P.sh.: kemi një kompani e cila merr shumën totale prej 251 mijë e 384.61 euro nga shuma e këtyre investimeve, që kur ta llogaritsh plus tjetëren që ky person mund të jetë po supozoj i njëjtë, ka edhe përfitime nga projektet e bëra, që d.m.th se nga projekte që ia ka bërë në bazë të prokurimit ai veq i dinë, d.m.th të gjitha paramasat. Edhe jep një vlerëism apo bënë një konkurim duke i përshtatur ato apo duke mos pasur për mundësi që operatori tjetër ta përfitoj atë, sespe vetë e ka kry atë dhe vetë e merr projektin. Unë këtu kam shumë dyshime, ndoshta janë dhe të pabaza, por unë po mendoj që janë të bazuara. Kjo sipas meje i bjen sikur një të uritur ta ulesh në një sofër

dhe ti ofrosh ushqime që ai kurr jo që nuk i ka hanger, por kurr nuk i ka parë, dhe ai i shkreti e një vetëm gjizën dhe specat. Hanë gjizë dhe specat, kurse artikujt tjerë që janë më të mirë i lenë, sepse nuk dinë si ti përdor.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Nexhat, atë të cilën ti po e thu, në mos përputhje mes planifikimit të hyrave vetanake dhe realizimit, që diku ki më shumë diku më pak, te trendi është problematik në organe të administratës. Ti ke një përvojë, ti po më habit më së shumti për këto pyetje që po i bënë. Ato merren disa barometra hipotetikiht as nuk e dinë sa ndërtime do të ndërtohen, as nuk e di sa objekte do të legalizohen. Te tatimi në pronë është pak më i përafërt, megjithatë edhe aty e dinë që kemi bërë në një ndërhyrje, disa falje kemi bërë dhe si kuvend komunal, dhe është një mospërputhje, por ajo që na gëzon është për shkak se të hyrat vetanake u kalu plani të cilën në dhjetor e kemi parapa. Te çështja e shpenzimeve, konsideroj që të gjitha kodet në i plotësojmë ato standartet, se i ki 97, 98, 99 të planifikimit dhe shpenzimit, që konsideroj për aspektin ekonomik është çështje e mirë. Çështja të cilën e shtroj Remziu, që do ta kisha shtrud edhe unë, por edhe Remziu e dinë këtë çështje, se vendimet gjyqësore figurojnë te investimet kapitale, se mjetet janë marrë te investimet kapitale, prandaj nuk mundet me e titullu ndryshe. Këtë rast mundet me shti në kllapa, me thanë këto nuk janë investime kapitale, janë vendime gjyqësore, të cilat kanë fitu individ të cilëve ju ka cenuar një e drejtë. Po e marr një shembull, se ato shumica janë mbi 90% të kontratës kolektive. D.m.th vendime individuale që kanë rrjedh nga kontrata kolektive dhe nuk kemi mujt me i titullu ndryshe. Çështjen të cilën i ki shumë të kuart Nexhat, pyete kush ka kanalizim. Ti e ki ndërtimi i kanalizimit “Berisha Compani”, ndërtimi i kanalizimit “Dem Bau” operator, ndërtimi i kanalizimit “Kushtrimi NM”, dhe nga këto i ke tri kompani të cilat kanë pas kontratë për ndërtimin e kanalizimit në pjesë të ndryshme të Komunës së Vitisë. Kërkun nuk ki kanalizim të lokalitetit, ku fatmirësisht i kemi rregullu, po ki lagje të ndryshme të cilat i kanë rregullu. Çështjen që e shtrove, pse te ujësjellësi janë shifrat e njëjta. Qaq ka pas pare për atë vit edhe për atë kompani, dhe në momentin që i ka kry ato i ka marr ato mjete. Qashtu kanë qenë të parapamë. E thave ka përfundu kontrata e operatorit ekonomik. Në rast se ka përfundu ajo, nuk mundet me i ekzekutu faturat, nuk mundet duhet ta kesh të kuart. Taulani e shtroj një brengosje lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve 35 mijë, tha një shumë shumë e madhe, e krahasoj edhe kompaninë e vetë. Unë po mendoj që ti Taulant ki të bëjë me automjete të cilat nuk hinë në sorrisha e në kodra. Na i kemi edhe zjarrfikësat, bëjnë pjesë këtu shpenzimet me të mëdhaja, në këtë rast i bëjnë zjarrfikësat. Tani edhe QKMF-ja, se aty binë edhe shtat a tetë automjete që janë për raste emergjente, e pajisjet me kompjutera janë për punëtorë e për shkolla. Tek çështja e mobileve duhet me pas parasyshtë, nuk janë vetëm karrigat, po binë edhe bankan në shkolla dhe është qajo shuma. Këtë çështje detalish me kërkun siç e kërkoni shumë segmente. Këtë prezetim analitik ne nuk mujmë me e ofru në pasqyra financiare. Ju e dini këtë, e ban pyetjen ose shkon në Drejtorinë e Financave detalisht e merr informatën.

z.Nexhat Halili: Nënkryetar, po të ishte i njëjti rast i shpenzimeve dhe të hyrave vetanake, tek shpenzimet merret krahasimi i buxhetit të aprovuar me buxhetin e shpenzuar, edhe pse buxheti i planifikuar ndryshon, mirëpo tek të hyrat e bartuara prej viti të kaluar, donacionet e rrisin buxhetin. Okej, mirë, përshembull edhe tek të hyrat vetanake të të hyrat e tjera që janë prej qeverisë, po të cilat i inkason komuna, edhe aty duhet të planifikoni. Deri në vitin 2020 komuna ka planifiku, prej vitit 2021 keni fillu këtë trendin tjetër, duke mos planifiku po vetëm duke i realizu kanalizimet. Nënkryetar, tri pozicione të kanalizimeve, më herët, vitin e kaluar e keni potencu me emra të fshatrave edhe në buxhet, edhe në pasqyra financiare, e jo tash rregullimi i kanalizimit, e nuk po e di tash ku janë këto kanalizime. Duhet me e ditë. Sa i përket kontratës për trotuarin, në vitin 2023 ka përfundu kontrata. Nuk e di unë në bazë të shkafit kryen punë ai operator ekonomik. Merrne këshyrne, analizone. Ujësjellësi edhe këtu është e vërtet se është nënë menaxhimin e “Hidromoravës”, po qytetarët ujë të pijes nuk kanë.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Falemidnerit të gjithëve për kontributin e dhanë! Edhe kjo është informatë, nuk votohet, kalojmë në pikën tjetër.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronën komunale përmes ankandit publik

Nuk kemi përfaqësues të drejtorisë, këtu as drejtoreshën as dikan tjetër nga kadastri që të ja japin informatën. Nuk e di a ja vlenë me e diskutu. Ne kemi thanë edhe më herët që, nëse nuk janë drejtorat, ato pika banë me i hek prej rendit të ditës. Tash është mendimi i juaj.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Unë nuk du me e prishë vendimin e juaj, nëse ju mendoni që pa prezencën e shtymë për mbledhjen e radhës.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Ne kemi pas marr vendim me herët se, nëse nuk është prezent drejtori, përfaqësues i drejtorisë për pikën e vet që e sjellin, mos me e shqyrtu, me shty për seancën tjetër. A jeni që kjo pikë të heket nga rendit i ditës, dhe të mbetet për seancën e radhës. Kush është për? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me të gjithë të pranishmi kjo pikë mbetet për seancën e radhës. Edhe pika e pestë ndërlihet me këtë pikë. Pra, këto dy pika shtyhet për seancën e radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:40 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi



Pratuar / Prilipeno / de / Data	Nr. / Kategorimi / Proje / Nr.	Shprehja / Vendi / Vendi	Vlera / Vrednost
1-02-2025	02-035	02-	92

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28, qershor 2008) neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me neni 14, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019) dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja I), të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491, Kryetari i Komunës me datën 09.01.2025, bën këtë :

PROPOZIM VENDIM PARAPRAK PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE PËRMES ANKANDIT PUBLIK

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim paraparak, propozohet dhënja në shfrytëzim e pronës së palujtshme të Komunës së Vitisë, në shfrytëzim afatshkurtër përsonave fizik dhe juridik si në vijim:

1. Pjesën prej 300m² të njesisë kadastrale P-70101005-00630-0, nga sipërfaqe e përgjithshme prej 13282m², Toka bujqësore, kullosë e klasit të 5, në vendin e quajtur "Zabel" në zonën kadastrale në Terpezë, e cila evidentohet në pronësi të Komunës së Vitisë.

Neni 2.

Afati kohorë për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale është afat shkurtër me kohëzgjatje prej 15 viteve me destinim kulturave bujqësore me qëllim të shfrytëzimit nga ana e personave fizik apo juridik.

Neni 3.

Qëllimi i dhenjës në shfrytëzim të pronës komunale është Interesi Publik dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale.

Neni 4.

Procedurat për dhënjën e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës.

Neni 5.

Menyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së palujtshme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfituesit marrjes në shfrytëzim të pronës së palujtshme në periudhë afatshkurtër të shfrytëzimit me të drejt të shkeputjes së kontratës edhe para afatit nese prona e dhënë në shfrytëzim nuk shfrytëzohet për qëllime të cekura në nenin 2 të këtij vendimi.

Neni 6.

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjent dhe Drejtoria e Financave të komunës së Vitisë.

Neni 7.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:

Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministerstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101005-00630-0


Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 177/2025
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 11.02.2025 - 11:03
Komuna / Opština / Municipality: VITI / VITINA / VITI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Tërpezë / Tërpeza / Tërpezë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përkthim Opis Description	Krijuar më datën Uradleno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70101005-00630-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shtetërore / Drushvena Imovina / Socially owned Land		13282			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradleno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ZABEL				



Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

[Signature]




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Tërpezë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70101005-00630-0	Parcelë / Parcela / Parcel	13282



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1969

Handwritten notes and stamps at the bottom of the page.



Pratime / Priloge / G. Data: 11-02-2025			
Nr. Dokument / No. Dokument / No. Document	Nr. / No. / No.	Subjekt / Tema / Subject	Vlera / Vrednost / Value
02-035/02-			93

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008, nenit 17 pika 2 lidhur me pikën 6 të Ligjit për dhënjën e pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim nr.06/L-092, neni 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbim e pronës së palujtshme të komunës dhe neni 10 paragrafi 2 pika i lidhur me nenin 50 pika 1. të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491, Kryetari i Komunës së Vitisë me datën 09.01.2025 bënë këtë :

PROPOZIM VENDIM

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës

Neni 1

Me këtë propozim – vendim , propozohet të formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes ankandit publik për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim afat shkurt deri 15 vite (pesmbëdhjet vite) për njësin kadastrale me nr. P-70101005-00630-0, në zonën kadastrale në Terpezë, pjesa prej 300m², sipas çartifikatës së pronës evidentohet në pronësi të Komunës së Vitisë.

Propozohet që komisioni sipas pikës 1 të këtij propozim- vendimi përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve si në vijim:

- Fatmir Salihu- anëtar i komisionit-Përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës.
- Fitim Selmani - anëtar i komisionit – Përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës
-- Përfaqësues i Kuvendit të Komunës
-- Përfaqësues i Kuvendit të Komunës
-- Përfaqësues i Sektorit jo qeveritar.

Neni 2

Me këtë propozim- vendim , detyrat e Komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së palujtshme të komunës Nr.06/L-092 i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr.10, të datës 03.04.2019) dhe Rregullorës Nr.09/2020 për Përcaktimin e Proedurave për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim e Pronës së Palujtshme të Komunës.

Neni 3

Kuvendi i Komunës së Vitisë e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënjes në shfrytëzim afat shkurt të pronës së palujtshme të komunës ti zhvilloj proceurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.

Neni 5

Për zbatimin e këtij propozim-vendimi do të kujdesesen; Kryetari i Komunës , anëtarët e komisioni dhe Zyra e Prokurimit në komunën e Vitisë.

Neni 6

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:

Sokol Haxhiu





Pranuar - Pranimë më Datë 12-03-2025			
Nr. i Organiut Org. Bë.	Nr. i...	Viteve...	Vlera Vrednost
02-085/02-			200
Lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës			

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen e Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28, qershor 2008) dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.2, neni 8 paragrafi 1 pika 1.2 lidhur me neni 14, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019) neni 5 paragrafi 1 pika 1.3 neni 6 dhe 13 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjës në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja I), të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës me datën 10.03.2025, bënë këtë :

PROPOZIM VENDIM

Paraparak për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim paraparak, propozohet të jepet pëlqimi për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme të Komunës së Vitisë, në shfrytëzim afatgjatë përsonave fizik dhe juridik deri në 20 vite, për përpunimin e mbeturinave, respektivisht shfrytëzimin për energji të rinovushme, përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Neni 2.

Prona e palujtshme për dhënjën në shfrytëzim, sipas nenit 1 të këtij propozim –vendimi janë:

1. Njësia kadastrale me nr. P-70101003-01607-2, në zonën kadastrale në Binçë, në vendin e quajtur Malishtë, me kulturë tokë tjetër jo pjellore, pjesen e sipërfaqës prej 20000 m² nga sipërfaqe e përgjithshme e cila ka 32552 m², e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.

Neni 3.

Qellimi i dhenjës në shfrytëzim të pronës komunale është Interesi Publik dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale.

Neni 4.

Procedurat për dhënjën e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë realizohet përmes shprehjes së inereit, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjës në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të Komunës.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Zyra Administratës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjent dhe Drejtoria e Financave të komunës së Vitisë.

Neni 6.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedetit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101003-01607-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 2552/025v
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 11.03.2025 - 13:47
Komuna / Opština / Municipality: VITI / VITINA / VITI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Binçë / Binae / Binçë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70101003-01607-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL.	Pronë shtetërore / Drzhtvena Imovina / Socially owned Land		32552			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Postanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
MAJLISITE				

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Nexhat Xhehiti | P-70101003-01607-2 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person
 1 / 2




A.2 LLOJII I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broji Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area
1	Take Tjetër/Oshtalo Zemljiste/Othert land	Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive		32552

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosto adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	Komuna e Vitisë	600424486	///		28 NENTORI	1/1		





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: _____ Viti _____

Nr. i njesisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: _____ 1607-1 _____


Zona kadastrale / Katastarska zona: _____ Binçë _____

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njesisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: _____ Parcelë _____

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: _____ 2000 _____

Me kërkesë të palës Nue Gega me numër personal 1002796496 nga Binça, është bërë inxhizimi i gjendjes faktike në terren në parcelën 1607-1 Z.K Binçë, Komuna e Vitisë, kjo parcelë bazuar në regjistrat zyrtar kadastral të Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi (DKPGJ) të Komunës së Vitisë, evidentohet në emër të "P.SH Kuvendi Komunal Viti" me sipërfaqe të përgjithshme prej 3496329 m², ku nga kjo parcelë pala Nue Gega kërkon të marrë në shfrytëzim sipërfaqen e propozuar në skicë/manual të matjeve prej 5000 m² në Z.K. Binçë. Në manual/skicë me ngjyrë të kuqe është paraqitur forma dhe shtrirja gjeometrike e parcelës-sipërfaqës së propozuar 5000m².



Lista e koordinatave të propozim ndarjës

Nr	Y	X
1	7530474.681	4684059.574
2	7530550.297	4684019.719
3	7530574.099	4684006.541
4	7530615.079	4683972.300
5	7530635.628	4683932.899
6	7530651.775	4683850.420
7	7530638.106	4683853.480
8	7530629.295	4683893.203
9	7530621.843	4683929.611
10	7530607.691	4683950.039
11	7530588.308	4683966.225
12	7530496.357	4684027.804
13	7530472.938	4684056.926

Rilevoi / Snimio: _____ Valton Sylja
(emri dhe mbiemri i gjeovetit/kompanisë/ ime i prezantuesit/kompanisë)

Nr. i licencës / Br. licence: _____ 104 _____

Nenshkrimi / Potpis: _____

V.V.

Data e rilevimit / Datum snimanja: _____ 14.03.2025 _____





Pratim i Punëve të Përgjithshme 12-03-2019			
Nr. i Propozimit	Nr. i Aktit	Titulli	Vlera
02-	035/02-		201

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008, nenit 17 pika 2 lidhur me pikën 6 të Ligjit për dhënjën e pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim nr.06/L-092, neni 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbim e pronës së palujtshme të komunës dhe neni 10 paragrafi 2 pika i lidhur me nenin 50 pika 1, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë me datën 10.02.2025 bënë këtë :

PROPOZIM VENDIM

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës afatgjat

Neni 1.

Me këtë propozim -- vendim , propozohet të formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes konkurimit të hapur për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim afat gjatë deri 20 vite (njëzet vite) për njësia kadastrale me nr. P-70101003-01607-2, në zonën kadastrale në Binçë, me sipërfaqe prej 32552 m², e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.

Propozohet që komisioni sipas pikës 1 të këtij propozim- vendimi përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve si në vijim:

- Xhehal Veseli- anëtar i komisionit-Përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës.
- Alban Sokoli - anëtar i komisionit – Përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës
-- Përfaqësues i Kuvendit të Komunës
-- Përfaqësues i Kuvendit të Komunës
-- Përfaqësues i Sektorit jo qeveritar.

Neni 2.

Me këtë propozim- vendim , detyrat e Komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së palujtshme të komunës Nr.06/L-092 i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr.10, të datës 03.04.2019). Komisioni vlerësohet me procedurat mbi dhënjën e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim përmes shprehjes së interesit.

Neni 3

Kuvendi i Komunës së Vitisë e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënjes në shfrytëzim afatgjat të pronës së palujtshme të komunës të zhvillojë procedurat e konkurimit të hapur dhe vlerësimin e ofertave.

Neni 5

Për zbatimin e këtij propozim-vendimi do të kujdesesen anëtarët e komisioni dhe Zyra e Prokurimit në komunën e Vitisë.

Neni 6.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës
Sokol Blatnjak

